



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI

### Ekstrakt

**nga procesverballi i mbajtur më 01 qershor 2015, në mbledhjen e XVII-të (shtatëmbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës.**

Mbledhja filloi në orën 10:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit, Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe, z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

Në cilësinë e mysafirëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin edhe një grup i nxënësve të shkollave të mesme të ulta të qytetit të Podujevë.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit z.Mehmet Gashi, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, në veçanti përshëndetë dhe iu uron Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve nxënësve të cilët për nderë të kësaj dite morën pjesë në mbledhje.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se rendin e propozuar të ditës dhe materialin përkatës e keni marrë me kohë, mirëpo ndërkohë pasi është thirrur kjo mbledhje, nga Ministria e Financave është dërguar një instruksion në të cilin thuhet se deri më 5 qershor 2015 komunat kanë të drejtë të rishikojnë buxhetin, në të kundërtën konsiderohet se nuk kemi nevojë për rishikim, pra kemi një çështje paksa urgjente dhe në këtë aspekt na është dashur që të premtën në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave të përfshijmë në rend të ditës si propozim vendim shtesë ku edhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim, propozim të cilin e keni pranuar me konstatime të rekomanduar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, nëse ka të interesuar për të marrë fjalën, urdhëroni.

**z.Haki Rudari**, theksoi, është e vërtetë që në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është debatuar për propozim vendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2015, unë në emër të Grupit të këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje e kam kundërshtuar këtë propozim për arsye se materiali përkatës na është ofruar aty për aty. Gjithashtu na është thënë se është urgjente dhe ne kemi kërkuar që nëse është nevoja mund të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit, por jo të përfshihet në rend të ditës si pikë shtesë në këtë mënyrë sepse nuk kemi pasur material për të analizuar, megjithatë kjo ka

kaluar me shumicë të votave. Pra unë edhe sot shprehi të njëjtin shqetësim dhe kërkoj që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Po ashtu për këtë mbledhje kam dy propozime për përfshirje në rend të ditës;

1-informatë për ndarjen e bursave, dhe 2-informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për mbjelljet pranverore dhe subvencionet që janë bërë. Besoj se këto dy pika do të plotësonin rendin e ditës dhe do të jenë në interes të qytetarëve.

**z.Fatmir Rudari**, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës dega në Besianë, ju njoftoj, që nga sot PDK për shëf të Grupit të këshilltarëve nominon z.Rafet Llapashticën, ndërsa për anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa nominon z.Flakron Gashin dhe znj.Endritë Muratin, kurse në Komisionin për dhënien e pronave publike në shfrytëzim nominon z.Ismajl Krasniqin, dhe në Komitetin për Komunitete nominon z.Fatmir Rudarin.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, sa i përket kërkesave që i bëri z.Haki Rudari, unë disa herë e kam thënë se për tu futur një pikë shtesë duhet që paraprakisht të jenë të përgatitur edhe Ekzekutivi i Komunës, ne mundemi që sot të rekomandojmë që për ndonjë mbledhje të radhës të përfshihen edhe ato dy pika, mirëpo tani konsideroj se është pamundshme të debatohet për diçka, pa pasur material, jo vetëm në këtë mbledhje por në asnjë mbledhje nuk mund të debatojmë pa pasur material të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës, por sido që të jetë është kërkesë dhe nëse votohet atëherë do të debatohet. Sa i përket propozim vendimit për Rishikimin e buxhetit për vitin 2015, besoj se materialin e keni marrë më 29.05.2015 të gjithë këshilltarët dhe gjatë vikendit keni pasur kohë të mjaftueshme ta analizoni, gjithashtu prezent janë edhe drejtorët e Drejtorive të cilët do të japin sqarime dhe arsyetime për çka do që kërkohet. Pra nevoja për rishikim të buxhetit është, të drejtë ligjore kemi por nuk kemi afat për të thirr mbledhje tjetër sepse kemi vetëm edhe dy ditë në dispozicion, prandaj konsideroj se është mirë që sot të marrim vendim për këtë. Lidhur me kërkesën apo njoftimin që e bëri z.Fatmir Rudari, unë e uroj z.Rafet Llapashticën për shëf të Grupit të PDK-së dhe besoj se do të kemi bashkëpunim të mirë, ndërsa kërkesat ose nominimet që u propozuan për Komitete dhe Komisione tjera të Kuvendit ne do t'i shqyrtojmë të gjitha në një prej mbledhjeve të radhës sepse kërkesa me shkrim është, mirëpo janë disa procedura të cilat duhet të respektohen, ngase fillimisht duhet të kaloj në Komitet për Politikë dhe Financa, pastaj t'i rekomandohet Kuvendit për miratim.

Për të mos e zgjatur më shumë, unë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara të Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht përfshirjen në kuadër të rendit të ditës edhe pikën shtesë, propozim vendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2015.

*Pas votimit u konstatua se me 21 vota për, 12 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe në kuadër të pikës së pestë të rendit të ditës përfshihet edhe pika shtesë:*

- **Propozimi i Vendimit për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2015**

**z.Haki Rudari**, nënvizoi, pati dy propozime për përfshirje në kuadër të rendit të ditës, andaj kërkoj që të hedhën në votim, kaluan apo nuk kaluan, të hedhën në votim.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, ju votuat kundër dhe kjo konstatua, kurse rendi i ditës u miratua me shumicë të votave, atëherë mendoj se nuk kemi çka e hedhim në votim sepse kjo u miratua një herë.

**z.Fidan Rekaliu**, theksoi, Kryesuesi i Kuvendit e sqaroi shumë mirë, se në momentin kur një propozim hedhet në votim dhe ai propozim kalon, atëherë propozimet tjera automatikisht biejnë sepse demokracia e thotë kështu, pra në rast se fillimisht propozimi i parë merr shumicën e votave, propozimet tjera nuk hedhën në votim fare për shkak se nuk mund të votojmë dy herë për të njëjtën çështje, edhe për edhe kundër. Kështu që mendoj se ne mund të vazhdojmë me rendin e ditës sipas rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe rendit të ditës që sapo u miratua.

**z.Haki Rudari**, theksoi, dua të sqarohemi, çështja e propozim vendimit për rishikim të buxhetit si pikë shtesë kaloi dhe u fut në rend të ditës për këtë mbledhje, krejt në rregull për ju kurse për ne jo, sepse me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale parashihet që thirrja dhe materiali të dërgohet 7 ditë pune para mbledhjes, andaj për këtë çështje ne votuam kundër, mirëpo unë bëra dy propozime tjera për të cilat nuk u votua fare.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se rendi i ditës u miratua së bashku me rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa, përkatësisht si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës u përfshi edhe propozimi i vendimit për rishikimin e buxhetit për vitin 2015, andaj mund të vazhdojmë me punë.

## **2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 30 prill 2015**

**z.Rafet Llapashtica**, fillimisht përshëndeti të pranishmit, nxënësve prezent iu uroi Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe uroj që Komuna e Podujevës të krijoj kushte sa më të mira për zhvillim të proceseve mësimore.

Sa i përket kërkesës së z. Haki Rudarit, unë në mënyrë verbale u solidarizova, mirëpo e kuptoj që Kryesuesi i Kuvendit nuk mundi t'i hedh në votim kërkesat për përfshirje në rend të ditës për arsye se Komuna është duke u qeverisur e cinguar sepse ende nuk janë emëruar drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kështu që konsideroj se kërkesat e të përmendurit janë plotësisht të drejta, dhe mendoj që, në çoftë se do të kishte drejtorë dhe ata të ishin prezent në mbledhje, do duhej që gjithherë të jenë të përgatitur për t'ju përgjigjur kërkesave të tilla, kështu që nga Kryesuesi nuk u hedhën në votim ngase nuk ka kujt t'i jepet fjala për të dhënë përgjigje dhe sqarime rreth atyre kërkesave.

Sa i përket Ekstraktit të procesverbalit unë kam vërejtje në procesmbajtësin, dhe te shtypja e transkriptit, te fjala e Kryetarit të Komunës, në faqen njëmbëdhjetë, ku unë kam bërë pyetje, përse nuk zbatohet vendimi i Gjykatës nga Kryetari i Komunës rreth kthimit në punë të punëtores Hanëmshahe Berisha, megjithëse ai incizim ekziston dhe e posedoj edhe unë, dua të them se nuk është përfshirë fjala e plotë e Kryetarit, andaj meqë procesmbajtësi është prezent këtu, kërkoj që të futet në atë procesverbal dhe në seancën e radhës së paku mua të më jepet përgjigja e Kryetarit të Komunës. Rreth procesverbaleve unë asnjëherë nuk kam qenë konfuzë si në KPF ashtu edhe në Kuvend që të këmbëngulim shumë rreth fjalëve të personave jo ekzekutiv, kurse te fjala e Kryetarit po, sepse unë mendoj se një Kryetar i cili nuk e zbaton vendimin e Gjykatës kjo është e rëndë për gjithë qeverisjen komunale si për pozitën ashtu edhe për opozitën, pra

është vendim i Gjykatës së Apelit si shkallë e fundit dhe pa të drejtë ankese, andaj mendoj se është dashur të jepet një përgjigje profesionale, ose në çoftë se nuk ka pasur përgjigje aty për aty, e që secili prej nesh mund të mos jetë i përgatitur të jap ndonjë përgjigje, është dashur të thotë se një përgjigje do ta japim në seancën tjetër, por në transkript duhet të përfshihen fjalët e të gjithëve këtu çka thuhet sepse është fjalë publike. Unë mund të shkoj në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe të marrë transkriptin përkatës, mirëpo është mirë që zyrtarët komunal të kryejnë detyrën e vetë secili qysh i takon, pra kjo është vërejtja ime sa i përket procesverbalit të seancës së kaluar.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, incizimet e diskutimeve ekzistojnë dhe në harmoni me rregullat është shërbimi i cili i kryen këto punë, andaj e hedh në votim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 30 prill 2015, ndërsa çështja e cekur nga parafolësi të shqyrtohet dhe krahasohet dhe nëse është e qëndrueshme atëherë të inkorporohet në ekstrakt të procesverbalit.

*Pas votimi u konstatua se Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri me konstatim që të shqyrtohet çështja e shtruar nga parafolësi.*

### **3. Propozimi i Vendimit për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. Podujevë**

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, meqë ky propozim dhe themelimi i komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim, hynë në fushëveprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, fjalën ja jap drejtorit të kësaj Drejtorie.

**z.Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e paraqiti fjalën hyrëse, ku ndër të tjera shtoi, është mirë që Kuvendi i Komunës të ngritë këtë komision sipas ligjeve në fuqi në mënyrë që pastaj ky komision të filloj me punën e vet konform ligjeve përkatëse, siç janë emërimi i drejtorëve dhe i ekzekutivit të ndërmarrjes me qëllim që të arrihet fillimisht funksionalizimi i asaj ndërmarrjeje.

**z.Fidan Rekaliu**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë propozim vendim dhe për anëtarë të komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike për banim, propozojmë z Hasan Softollin dhe znj. Mrikë Thaqi.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, në Komitetin për Politikë dhe Financa kemi diskutuar rreth nominimeve të anëtarëve për ngritjen e këtij komisioni, ligji përkatës nuk e specifikon se a duhet që anëtarët të jenë nga radhët e Kuvendit të Komunës apo mund të jetë edhe ndokush jashtë Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit në mbledhjen e KPF-së e tha se kjo do të vendoset në Kuvendin e Komunës, kurse parafolësi i propozoi dy kandidat prej subjektit LDK, kurse një anëtar i komisionit sipas ligjit emërohet nga Kryetari i Komunës, atëherë subjekteve opozitare nuk iu është lënë hapësirë që ndonjëra të kenë përfaqësuesin e tyre në këtë komision, sepse Kryetari i Komunës e emëron një anëtar, kurse nga Kuvendi u propozuan z.Hasan Softolli dhe znj.Mrikë Thaqi, që do të thotë se janë tre anëtarë, e që edhe duhet të jenë tre, atëherë edhe ne Grupet tjera mund t'i propozojmë nga dy anëtarë, që mendimin tim do të ishte diçka e keqe, andaj unë mendoj se me formimin e Grupit të ri Grupi Plus, dhe me qëllim që mbikëqyrja e bordit të jetë sa më e mirë është dashur t'i lihen të gjitha Grupeve të këshilltarëve nga një anëtar në komisionin e aksionarëve, kurse

kryesuesi i komisionit të jetë nga cili do subjekt. Unë absolutisht nuk kam dyshim se disponimi për tu marrë me këtë ndërmarrje është vetëm i LDK-së, mirëpo nëse është disponim i Kryesuesit të Kuvendit apo i Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit të Komunës që këtë bord ta mbikëqyr vetëm LDK-ja, neve absolutisht vetëm na lironi nga obligimet që të merremi me atë ndërmarrje për të cilën edhe ashtu mendojmë se nuk do të shkon mirë, kështu që Partia Demokratike e Kosovës, për dallim nga parafolësi i cili propozoi dy emra, ne kemi vetëm një emër për anëtarë të komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike për banim dhe ai është z. Sabri Hamiti, sepse mendoj se në bazë të numrit të këshilltarëve që kemi në Kuvend neve na takon të kemi një përfaqësues në atë komision, andaj të mos bëjmë propozime me nga dy anëtar por të bëjmë propozime konkrete sepse tre anëtarë duhet të jenë krejt në atë komision.

**z. Bahri Selimi**, theksoi, duke parë rëndësinë e punës së këtij komisioni Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje parasheh se është mirë që këtij komisioni t'i shtohet një anëtarë nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe në emër të Grupit, propozoj që anëtarë në komisionin e aksionarëve të ndërmarrjes publike për banim të jetë znj. Adelinë Stublla.

**z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, ne tani para vetës kemi tri propozime për dy anëtarë të këtij komisioni, sepse sipas ligjit një anëtar e emëron Kryetari i Komunës. Unë si Kryesues i Kuvendit më është dashur të përcjell edhe komunat tjera se si kanë vepruar në këtë drejtim, ku pothuajse në shumicën e Komunave është bërë praktikë që ai subjekt i cili e ka shumicën në Kuvend ai edhe i zgjedhë apo emëron anëtarët e komisioneve të aksionarëve nga radhët e veta, kështu që unë do t'i hedhë në votim një nga një të tri propozimet e bëra nga parafolësit.

**z. Haki Rudari**, theksoi, është e vërtetë që në Komitetin për Politikë dhe Financa është debatuar për këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo ka mbetur që propozimet e anëtarëve të bëhen sot në Kuvend. Unë me të vërtetë prita që LDK të propozoj vetëm një anëtar e jo dy siç ndodhi, atëherë në një mënyrë mos të hedhet në vota fare sepse me aklamacion mundeni me i zgjedhë, mirëpo për hir të demokracisë është mirë që një anëtar i komisionit të jetë nga radhët e subjekteve që janë në opozitë, mendoj se po të ishte Kryetari i Komunës këtu prezent edhe ai vet do të kërkonte që një anëtarë të jetë nga opozita, nuk ka rëndësi nga cili subjekt, dhe këtë duhet që vetë LDK të ketë parasysh.

**z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, nënvizoi, ju njoftoj se Kryetari i Komunës e ka propozuar një anëtar, si e drejtë e tij ligjore, por për dy anëtarë tjerë pati tri propozime të ndryshme, kështu që fillojmë me radhë, e hedh në votim propozimin e z. Fidan Rekalit.

*Pas votimit u konstatua se me 22 vota për, 12 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, u miratua propozimi i z. Fidan Rekalit që anëtarë të komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike për banim sh.a. Podujevë, përveç një anëtarë të cilin e emëron Kryetari i Komunës, të jenë z. Hasan Softolli dhe znj. Mrikë Thaqi.*

*Njëkohësisht Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se u miratua propozimi i vendimit për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike për banim sh.a. Podujevë, në këtë përbërje;*

1. Avni Fetahu, i emëruar nga Kryetari i Komunës
2. Mrikë Thaqi, e emëruar nga Kuvendi i Komunës
3. Hasan Softolli, i emëruar nga Kuvendi i Komunës

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, nuk e shoh të arsyeshme që Kryesuesi i Kuvendit të ketë kaq emocione për këtë pikë të rendit të ditës, sepse Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk e parasheh se sa duhet të zgjatë një seancë e Kuvendit, dhe ajo mund të zgjatë pak ose shumë por mund të vazhdoj edhe nesër, mirëpo mendoj se secili që dalim në foltore dalim me një arsyeshmëri. Kryesuesi e tha se Kryetari i Komunës e ka nominuar një anëtar, por unë mendoj se Kryetari i ka nominuar që të tre anëtarët nga subjekti LDK, ne e kuptojmë se LDK ka numrin më të madh të këshilltarëve dhe që qeveris në këtë Komunë dhe se pjesëmarrja duhet të jetë më e madhe, mirëpo më vie keq nga ju zotëri Kryesues, që ad-hoc dirigjohet seanca e Kryesuesit, kur vetë Kryesuesi është këtu prezent, sepse nuk ka vendim se si do të jetë, në qoftë se do të specifikohet me ligj në aspektin legal se si do të rregullohet kjo fushë, atëherë nuk do të zhvillohet debat. Kryesuesi i Kuvendit as në Komitetin për Politikë dhe Financa nuk ka mund të sqaroi se si dhe në çfarë mënyre do të jetë përbërja dhe si do të nominohen anëtarët e këtij komisioni, nga përbërja e Kuvendit, apo nga persona që nuk janë këshilltarë të Kuvendit, nga shoqëria civile apo nga ndonjë ekspert.

Pra këtu u vendos që një anëtar e emëron Kryetari sepse është e drejtë ekskluzive tij, ndërsa dy anëtarë tjerë i nominoi Grupi i këshilltarëve të LDK-së, dhe kjo u hedh në votim, kurse para se të marr fjalën unë Kryesuesi e tha se kjo pikë e rendit të ditës u përfundoi dhe u ngrit Komisioni përkatës. Atëherë ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës nuk e vazhdojmë këtë seancë. Jemi në dijeni se e keni shumicën, vendimi është marrë, mirëpo konsideroj se është vendim i njëanshëm dhe jo i mirë, si dhe çështja tjetër është se Rregullorja e Kuvendit është shkelur sepse materiali duhet të dërgohet 7 ditë pune para mbledhjes, në Rregullore kjo çështje është e specifikuar shumë mirë dhe është afati kohorë që këshilltarët duhet të shqyrtojnë materialin, kurse seanca është thirr para kohe. Nuk e dëshirojmë një gjë të tillë edhe pse jemi opozitë, mirëpo vendimi ishte i njëanshëm dhe jo demokratik, dhe të jeni të sigurt se po të më nominonte mua PDK-ja në këtë formë si e bëri LDK-ja, nuk do të pranoja të jem pjesë e këtij komisioni.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, nënvizoi, sa i përket thirrjes dhe dërgimit të materialit të mbledhjes, ju njoftoj se mbledhja është thirrur në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, pra është thirrur dhe u është dërguar materiali i mbledhjes 8 ditë pune para kësaj mbledhjeje, kurse sa i përket propozimit të pikës shtesë për përfshirje në rendin e propozuar të ditës këtë e ka rekomanduar Komiteti për Politikë dhe Financa, andaj nuk mund të ketë kurrfarë kundërshtimi sa i përket kësaj, kështu që mund të vazhdojmë me punë.

*Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, lëshon mbledhjen.*

**z.Haki Rudari**, theksoi, pajtohem plotësisht se partia në pushtet duhet ta ketë shumicën në komisionin e aksionarëve, mirëpo fillimisht mendova që me një konsensus të zgjedhim këtë problem dhe e ceka paraprakisht se do ta votoj edhe një anëtarë nga radhët e LDK-së, po ashtu mendova që edhe vet Grupi i LDK-së do të përkrah atë që një anëtarë i komisionit të jetë nga opozita, pra kjo ishte ajo që unë mendova se do të ndodh por nuk e di se sa u kuptova. Kjo nuk është demokraci, dhe në asnjë komunë nuk është vepruar në këtë mënyrë, unë i posedoj dy materiale, të Komunës së Vushtrisë dhe të Komunës së

Kaçanikut ku në asnjërën prej tyre nuk ka pasur rëndësi që anëtarët e komisionit përkatës të zgjedhën nga radhët e një partie në pushtet për arsye se partia në pushtet e ka shumicën dhe vendos në atë komision, kështu që në këtë rast që të jenë tre anëtarë të një komisioni të tillë nga radhët e një partie nuk i bënë mirë demokracisë dhe nuk është demokraci fare kjo, andaj me këto kushte as ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së nuk mund t'i vazhdojmë punimet.

*Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, lëshon mbledhjen*

*Para se të vazhdohet me punë, Kryesuesi i Kuvendit kërkon të konstatohet kuorumi.*

*Konstatohet se nga 35 këshilltarë të Kuvendit, prezent në sallë janë 23 këshilltarë, kështu që ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.*

#### **4. Propozimi i Vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore ( sipas kërkesës së Ditar Hotit nga Podujeva)**

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, fjala është për një kërkesë të parashtruar nga z.Ditar Hoti nga Podujeva, kërkesë e cila është shqyrtuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe i është rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, kështu që nëse ndokush dëshiron të marrë fjalën, urdhëroni, nëse jo unë e hedh në votim.

*Pas votimit u konstatua se njëzëri, përkatësisht me 23 vota për, u miratua ky propozim vendim*

#### **5. Propozimi i Vendimit për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2015**

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, e ftoi drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, të paraqes fjalën hyrëse lidhur me këtë propozim vendim, duke mos përjashtuar edhe drejtorët e Drejtorive tjera sipas nevojës.

**z.Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, fillimisht më duhet të kërkoj falje që kjo pikë është propozuar pas dërgimit të thirrjes dhe materialit për këtë mbledhje ku fillimisht është dashur që në Komitetin për Politikë dhe Financa tri ditë më parë të propozojmë për përfshirje si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës për të shqyrtuar dhe rekomanduar Kuvendit për shqyrtim, për arsye se instruksioni nga Ministria e Financave është dërguar pasi është dërguar materiali i kësaj mbledhje dhe ne si Ekzekutiv i Komunës menjëherë kemi filluar me procedura dhe analiza të buxhetit, pasi është rishikuar buxheti nga secila Drejtori, është përgatitur propozim vendimi i cili së bashku me konstatimet e KPF-së u është dërguar të gjithë këshilltarëve të Kuvendit menjëherë pas mbledhjes së KPF-së, sigurisht keni vërejtur se sipas Instruksionit të Ministrisë afati i rishikimit të buxhetit është vetëm deri më 05.06.2015, andaj nuk kemi pasur kohë të mendojmë shumë gjatë. Ky rishikim u është përmbytur të gjitha instruksioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për kategori të caktuara dhe të gjitha analizat janë vetëm brenda për brenda programeve, kështu që nuk dëshiroj të zgjati shumë rreth këtij

propozimi, por në qoftë se ndokush ka nevojë për ndonjë sqarim shtesë atëherë prezent janë drejtorët e Drejtorive përkatëse të cilët mund të japin sqarime dhe arsyetime.

**z.Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, për fat të mirë këtë vit Instruksioni i Ministrisë së Financave është dërguar më herët se viteve tjera që janë bërë në muajin korrik, megjithatë me një procedurë më të shpejt, sepse ashtu edhe është kërkuar, ne kemi analizuar dhe para jush kemi paraqitur këtë propozim. Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit janë rishikuar katër projekte në shumë të përgjithshme 66,100.00 € ose 4.18% e buxhetit të ndarë për këtë Drejtori, pra me këtë rishikim nuk janë bërë ndërhyrje të mëdha por kryesisht janë bartur mjete për investime kapitale për raste emergjente sepse në gjashtë mujorin e parë të vitit buxheti është shpenzuar vetëm 10% dhe dashtë zoti që deri në fund të vitit të mos ketë raste emergjente për t'i shpenzuar ato mjete. Në kodin për mirëmbajtje të rrugëve të asfaltuara ka tepriçë të mjeteve në shumë 15.000.00 €, pjesa tjetër është e Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, dhe 25,000.00 € janë në procedurë të prokurimit, si dhe dy projekte të cilat kanë pasur mungesë të mjeteve në vitin e kaluar, kanalizimi në fshatrat Llaushë dhe në Gërdoc, janë plotësuar tërësisht.

Gjithashtu të gjitha procedurat e prokurimit të cilat janë zhvilluar deri tani nuk kanë mungesë të mjeteve, pra shpresoj që deri në fund të vitit, me këto ndryshime që do të bëhen, do të realizohen të gjitha projektet e parapara në mënyrë që mos të kemi suficit në ndonjë kod të veçantë. Vlen të ceket se asnjë projekt nuk është hequr nga planifikimet.

**z.Fidan Rekaliu**, theksoi, fillimisht shprehi keqardhje për lëshimin e mbledhjes nga ana e Grupeve të këshilltarëve të PDK-së dhe atyre të LVV-së, e konsideroj si të panevojshme sepse shumë qartë është e specifikuar që Kuvendi i propozon dy anëtarë dhe Kuvendi voton për ato propozime dhe për vendimin në tërësi, kështu që znj.Mrikë Thaqi është këshilltare pavarur, kurse z.Hasan Softolli është nga radhët e LDK-së, andaj konsideroj se çdo gjë ishte në rregull dhe sipas dispozitave ligjore.

Sa i përket propozim vendimit për rishikimin e buxhetit për vitin 2015, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim dhe konsiderojmë se propozimi për rishikim është bërë në përputhje të plotë me ligjin për financat e pushtetit lokal dhe Instruksionin e Ministrisë së Financave si dhe konsiderojmë se të gjitha mjetet e rishikuara janë specifikuar shumë qartë në propozim vendim se ku merren dhe ku destinohen, pra edhe njëherë ne e përkrahim këtë propozim vendim dhe jemi për atë që Komuna e Podujevës të ketë zhvillim sa më të madh.

**z.Lutfi Rexhepi**, theksoi, kërkonte fjalën me qëllim që të parashtroj pyetje për Ekzekutivin e Komunës lidhur me këtë rishikim, dhe atë; a ka ndonjë projekt të realizuar apo që është në fazën e realizimit e që nuk ka qenë i planifikuar në vendimin e Kuvendit të Komunës, dhe pyetja tjetër është; a mendon Ekzekutivi i Komunës se vetëm asfalti dhe kanalizimi e përbëjnë infrastrukturën, gjegjësisht vetëm me asfalt dhe kanalizime realizohet zhvillimi i Komunës tonë, si dhe, sa do të kenë ndikim dhe efekt në zhvillimin e Komunës së Podujevës këto ndryshime të propozuara në këtë rishikim.

*Pas votimit u konstatua se nga 23 këshilltarë prezent në sall, me 22 vota për, 1 votë kundër u miratua propozimi i vendimit për rishikimin e buxhetit për vitin 2015.*



## 6. Të Ndryshme

**z.Fidan Rekaliu**, theksoi, kemi një kërkesë nga disa këshilltarë të Kuvendit që më 10 qershor 2015 të vizitohet Prizreni, për nderë të historikut që ka kjo datë, Lidhjes së Prizrenit, andaj kërkoj që të përkrahet kjo ide dhe të mundësohet realizimi i kësaj vizite për të gjithë këshilltarët e Kuvendit të cilët shprehin interesim për pjesëmarrje.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, nënvizoi, kërkoj nga shërbimi për punë të Kuvendit të procedoj këtë kërkesë për zhvillimin e procedurave të prokurimit për sigurimin e kushteve për vizitë të këshilltarëve të Kuvendit në Qytetin e Prizrenit më 10 qershor 2015.

*Kryesuesi konstatoi se të gjithë këshilltarët prezent në sallë e përkrahen këtë iniciativë.*

*Pasi më nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të mbyllur.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10;50**

**Procesverbalin e mbajti  
Enis Sheholli**

**Nr. 01-016-53829  
Podujevë,  
01 qershor 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Mehmet Gashi**